



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 105 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 26/ 07 / 2023

**VENDIM**

Nr. 23, date 26 /07/2023

**PËR**

**STUDIMIN PËR PËRHAPJEN E VALËS QË KRIJOHET NË ZONËN POSHTË DIGËS  
SË LIQENIT ARTIFICIAL TË TIRANËS**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 26.07.2023 mori në shqyrtim Studimin për përcaktimin e perhapjes së Vales në zonën poshte digës së liqenit Artificial të Tiranës I paraqitur nga UK Tirana.

Ky studim i pregatitur nga firma konsulente DEKLIADA ALB Institute në vitin 2017 është paraqitur në mbledhjen e KKDM të datës 19.04.2018 dhe për mangësi të konstatuara nuk është miratuar. KKDM me vendimin nr. 3, datë 19.04.2018 ka kërkuar plotësimin e të gjithë kërkesave sipas legjislacionit në fuqi. Studimi i paraqitur në mbledhjen e sotme të KKDM është i njëjti studim i paraqitur në vitin 2018 pa marrë në konsideratë asnjë prej kërkesave të Vendimit të KKDM. Gjithashtu, ky studim nuk merr në konsideratë asnjë prej zhvillimeve aktuale urbane të zonës poshte digës dhe nuk është i bazuar në volumet aktuale të ujit në rezervuarin e krijuar për shkak të mungesës së matjeve batimetrike.

Keshilli Teknik i Perhershëm i Digave (KTPD) i rekomandoi antareve të KKDM të mos miratojnë këtë Studim të paraqitur nga UK Tirana dhe të kërkojnë UKT hartimin e një studimi aktual me të dhëna aktuale të gjendjes së vitit 2023. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Të mos miratojnë Studimin e paraqitur për përcaktimin e perhapjes së valës në zonën urbane poshte digës së Liqenit Artificial të Tiranës
- 2- Ti kërkojnë Ndërmarrjes së Ujësjetës Kanalizimeve të Tiranës:
  - Të hartojë dhe të dorëzojë sa më shpejt të jetë e mundur për shqyrtim pranë KKDM, brenda vitit 2023, **Planin e gadishmerisë për emergjencat civile (PGEC) për ndonjë prishje të mundshme të digës së Liqenit Artificial të Tiranës apo shkarkimit të plotë maksimale në zonë.** Ky plan duhet të hartohet në bazë të ligjit Nr.45, datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen Civile", Udhezimit Nr. 248, datë 28.01.2000 "Për hartimin e Planit të Alarmit si dhe Vendimit të KKDM Nr. 5, datë 16.11.2020 "Për hartimin e Planeve të gadishmerisë në rastet e emergjencave civile". PGEC duhet të përmbajë llogaritjet për perhapjen e vales duke dhënë kohën, sipërfaqen, shpejtësinë dhe thellesinë e kesaj vale në zonën poshte digës, hartën e përcaktimit të zonës poshte digës të bazuar në zhvillimin aktual urban të kesaj zone, skenaret e mundshëm të emergjencave. Ky Plan duhet të përshijë edhe të gjitha kërkesat e KKDM të dhëna me Vendimin Nr. 3, dt.19.04.2018 si dhe vendimin e KKDM nr. 27.04.2022
  - Të hartojë dhe të dorëzojë sa më shpejt të jetë e mundur pranë KKDM **projektin e zbatimit për rehabilitimin e sistemit të shkarkimit dhe të ujeleshuesit të digës së Liqenit Artificial të Tiranës të cilat nuk janë rehabilituar që nga momenti i incidentit të ndodhur para 20 vitesh.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Te hartoje dhe te dorezoje sa me shpejt te jete e mundur brenda vitit 2023, prane KKDM projektin e zbatimit per monitorimin e diges se Liqenit Artificial te Tiranes dhe te filloj urgjentisht kryerjen e matjeve per monitorimin e diges sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi.
- Te kryeje matjet batimetrike per llogaritjen e volumit aktual te ujit ne Liqenin Artificial te Tiranes, te hartoj kurben aktuale te volumeve dhe te siperfaqes se ujit ne liqen si dhe te kryeje nje analize te sedimenteve dhe mbetjeve te tjera te ardhura ne liqen duke dhene edhe zgjidhjet per menazhimin e ketij problemi ne te ardhmen

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI  
Arjan JOVANI

